

LIGJ
Nr. 39/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOLEGJIT TË EVROPËS PËR HAPJEN
E DEGËS SË KOLEGJIT TË EVROPËS NË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës për hapjen e degës së Kolegjit të Evropës në Tiranë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 166, datë 26.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOLEGJIT TË EVROPËS “PËR HAPJEN E NJË DEGE TË KOLEGJIT TË EVROPËS NË
TIRANË”

Kjo Marrëveshje lidhet ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Arsimit dhe e Sportit, në vijim i referuar si “Këshilli i Ministrave”,
dhe

Kolegjit të Evropës, një organizatë jofitimprurëse e shërbimeve publike, e regjistruar dhe e licencuar në Belgjikë¹, e përfaqësuar nga rektorja, znj. Federica Mogherini, në vijim i referuar si “Kolegji”.

Në këtë Marrëveshje, Këshilli i Ministrave dhe Kolegji referohen bashkërisht si “Palët”.

Duke pasur parasysh se:

Kolegji, instituti më i vjetër pasuniversitar i studimeve evropiane i njohur për përsosmërinë akademike dhe përkushtimin për të kontribuar në integrimin evropian, aspiron të shtrijë aktivitetet e tij akademike në Republikën e Shqipërisë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor;

Republika e Shqipërisë përfaqësohet në Këshillin Administrativ të Kolegjit me një anëtar të emëruar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, siç përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit të datës 7 qershor 2023;

¹ Europacollege/Le Collège d'Europe|Dijver 11–8000 Bruges, Belgjikë|Fondacioni i Shërbimeve Publike|Numri i korporatës: 0409.518.855|Numri i TVSH-së: BE 0409.518.855|Regjistri i Personave Juridikë, gjykata e Gentit, Divizioni Bruges.

Më 2 tetor 2023 dhe në përputhje me nenet 4 dhe 10 të Statutit të Kolegjit, Këshilli Administrativ i Kolegjit miratoi shtrirjen e Kolegjit në Republikën e Shqipërisë, duke sjellë regjistrimin e një dege në Shqipëri të Kolegjit, krijimin e një departamenti të ri studimi me qendër në Tiranë dhe lidhjen e marrëveshjeve me qeverinë shqiptare dhe partnerë të tjerë bashkëpunimi për ngritjen e degës së Kolegjit në Shqipëri;

Më 6 tetor 2023 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Kolegjit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkisë së Tiranës, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së bashkëpunimit ndërmjet këtyre tri palëve, në lidhje me sigurimin e mjediseve dhe funksionimin e Kolegjit të Evropës në Tiranë;

Këshilli i Ministrave dhe Kolegji, duke njohur vlerën e arsimit të lartë në ecurinë e integritetit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian (BE), shprehin vullnetin e përbashkët për të hapur dhe për të mbajtur një degë të Kolegjit në Tiranë,

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Objektivat e përbashkët

Këshilli i Ministrave dhe Kolegji bien dakord që hapja e një dege të Kolegjit në Tiranë do të arrijë objektivat e mëposhtëm të përbashkët të Palëve:

a) Zhvillimi i sektorit të arsimit të lartë dhe i ekspertizës në fushën e studimeve evropiane në Republikën e Shqipërisë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor;

b) Ofrimi i një oferte unike akademike për studentët dhe profesionistët nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, BE-ja dhe më gjerë;

c) Kultivimi i një mjedisi shkëmbimi intelektual, mirëkuptimi dhe pajtimi ndërkombëtar dhe multikulturor, në përputhje me traditën e jashtëzakonshme akademike të Kolegjit dhe formulën e tij rezidenciale për të studiuar dhe jetuar Evropën së bashku.

Neni 2

Detyrimet e Palëve

Për qëllimin e parashikuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, ndarja e përgjithshme e përgjegjësiave përcaktohet, si më poshtë:

a) Këshilli i Ministrave, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, miraton hapjen, ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarisë akademike të degës së Kolegjit në Shqipëri.

b) Këshilli i Ministrave merr përsipër të mbështesë me çdo mjet ligjor të disponueshëm ngritjen, licencimin, njohjen e akreditimit të huaj, funksionimin dhe veprimtarinë e degës së Kolegjit në Shqipëri. Në këtë drejtim, Këshilli i Ministrave pranon të trajtojë çdo çështje rregullatore të arsimit të lartë universitar, në lidhje me funksionimin e veprimtarive të arsimit të lartë (niveli Master) në Shqipëri, siç parashikohet nga ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"², dhe çdo akt tjetër nënligjor në fuqi.

c) Këshilli i Ministrave miraton mbështetjen me bursa deri në 5 (pesë) bursa për vit akademik për shtetasit shqiptarë që do të pranohen në programet akademike të Kolegjit, me vlerë totale deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro për vit akademik.

d) Këshilli i Ministrave siguron objektet, infrastrukturën e nevojshme dhe sigurimin e ndërtimit/godinës për funksionimin normal të veprimtarisë akademike të Kolegjit. Pronat dhe asetet e vendosura në zotërim të Kolegjit për funksionimin e degës së tij në Tiranë, janë pronë e shtetit shqiptar. Ato i ofrohen Kolegjit për përdorim nëpërmjet kontratave specifike (afatgjata) të huas për përdorim, pa kundërshtpërbli, dhe të vendosura dhe të pajisura në nivel të mjaftueshëm për qëllimet e synuara akademike. Marrëveshjet do të nënshkruhen ndërmjet Kolegjit dhe njësi përgjegjëse ekonomike të cilat administrojnë pronat.

² Edhe në rast të ndryshimit apo të zëvendësimit të tij nga ndonjë ligj i ri zëvendësues.

e) Këshilli i Ministrave siguron, nëpërmjet autoriteteve publike përkatëse, zbatimin efektiv të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për organizatat jofitimprurëse, të ndryshuar, ligjin e procedurave tatimore, ligjin për arsimin universitar, marrëveshjen dypalëshe ndërmjet Komisionit të Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë³, Marrëveshjet e Shmangies së Tatimit të Dyfishtë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Belgjikës⁴ dhe çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi që ekziston ose që mund të miratohet në të ardhmen në lidhje me krijimin dhe funksionimin e degës së Kolegjit në Shqipëri, çdo çështje rregullatore nga e cila preket, të drejtat dhe përfitimet e tjera të tij, lehtësimet dhe përjashtimet tatimore etj. Këshilli i Ministrave pranon në këtë dokument se do të parashikojë një regjim përjashtimi tatimor për Kolegjin dhe degën e tij në Shqipëri nga çdo detyrim tatimor ose doganor, të çdo lloji ose natyre. Gjithashtu, meqë Kolegji dhe dega e tij në Shqipëri do të kenë statusin e përjashtimit total nga taksat, Këshilli i Ministrave merr përsipër që furnitorët që ofrojnë mallra dhe shërbime për Kolegjin dhe degën e tij në Shqipëri të mos ngarkojnë TVSH, kur faturojnë Kolegjin dhe degën e tij; pa kundërshtuar këtë, Këshilli i Ministrave siguron se rimbursimi i TVSH-së, nëse ka, do të bëhet me procedurë të përsheptuar.

f) Këshilli i Ministrave merr përsipër të ofrojë mbështetje me çdo mjet ligjor të disponueshëm për lehtësimin e marrjes së lejes së punës dhe të lejes së qëndrimit ose përjashtimit nga puna dhe/ose lejes së qëndrimit, siç zbatohet për punonjësit e huaj të Kolegjit dhe degës së tij në Shqipëri. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave siguron që këta punonjës të huaj, nëse ka nga Kolegji dhe dega e tij në Shqipëri, nuk janë të detyruar të paguajnë tatimin mbi të ardhurat personale të krijuara nga punësimi (TAP) dhe se Kolegji dhe dega e tij në Shqipëri nuk kanë asnjë detyrim të mbajnë në burim dhe/ose të paguajnë këtë taksë dhe ndonjë kontribut të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e huaj të degës së Kolegjit në Shqipëri.

g) Kolegji, i mbështetur nga një kuadër financiar i Komisionit Evropian, do të mbulojë të gjitha kostot që lidhen me funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe operacional të degës së Kolegjit në Tiranë, Shqipëri.

Secila nga palët e kësaj Marrëveshjeje do të bëjë përpjekjet më të mira për të mbështetur Palën tjetër në mirëbesim dhe për të ruajtur efektivisht të padëmtuar Palën tjetër nga çdo përgjegjësi që nuk është rezultat i veprimeve dhe/ose i neglizhencës së asaj Pale tjetër.

Neni 3

Aktiviteti Akademik

Programi/et e studimit që do të ofrohet/n nga Kolegji në Tiranë do të kenë të njëjtat standarde si ato të ofruara në departamentet e tjera të Kolegjit (në Bryzhit dhe Natolin/Varshavë), nën mbikëqyrjen e Këshillit Akademik të Kolegjit dhe të akredituar nga Organizata e Akreditimit e Holandës dhe Flanders (NVAO).

Rregullat dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, gjuhën e studimit, kohëzgjatjen e programit/eve, si dhe mbylljen e tyre, përcaktohen në aktet e brendshme rregullatore të Kolegjit.

Nga viti akademik 2024–2025 e në vazhdim, Kolegji, nëpërmjet degës së tij në Tiranë, angazhohet të ofrojë një program studimi pasuniversitar (cikli i dytë i studimeve, zbatohen kërkesat e pranimi të Kolegjit) për studentët dhe profesionistët nga:

i. Ballkani Perëndimor, të interesuar për specializim në studimet evropiane, me fokus në integrimin e rajonit në BE;

ii. Shtetet anëtare të BE-së, si dhe çdo shtet tjetër, i interesuar për studimet evropiane dhe Evropën Juglindore, me fokus në transformimet e ndryshme në kontekstin e zgjerimit të BE-së.

Neni 4

Standardet e organizimit dhe të kontrollit të veprimtarisë së degës së Kolegjit

³ Ligji nr. 9840, datë 10.12.2007, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për ndihmën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA)".

⁴ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9051, datë 14.4.2003, në fuqi nga data 1.1.2005 (Fletorja Zyrtare nr. 38, datë 23.5.2003, faqe 1279).

Standardet e organizimit institucional, struktura akademike, standardet e personelit akademik dhe statusi i tyre, procedurat për garantimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, verifikimi i ligjshmërisë dhe auditimi i veprimtarisë së degës së Kolegjit në Shqipëri, bëhen sipas rregullave në fuqi dhe nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës (Belgjikë).

Neni 5

Kriteret për pranimin dhe regjistrimin e studentëve

Rregullat dhe procedurat e parashikuara në aktet e brendshme rregullatore të Kolegjit zbatohen për pranimin e studentëve në programin/et e studimit që do të ofrohen nga dega e Kolegjit në Tiranë. Kjo përfshin regjistrimin, matrikullimin, si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve.

Neni 6

Diplomimi dhe diplomat

Për procedurën e diplomimit të studentëve dhe formën e diplomave të lëshuara nga Kolegji, zbatohen rregullat e parashikuara në aktet e brendshme rregullatore të Kolegjit.

Diplomat që lëshohen në fund të programit/eve të studimit të ofruara nga Kolegji njihen automatikisht në Republikën e Shqipërisë, sikur të jenë lëshuar nga ndonjë institucion tjetër universitar i krijuar dhe që vepron në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

Akreditimi institucional dhe i programit të studimit

Akreditimi institucional dhe programet e studimit të ofruara nga Kolegji, si dhe periudha e vlefshmërisë së tyre, të kryera nga organizatat akredituese të vendit të origjinës (Flanders, Belgjikë), njihen automatikisht nga institucionet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Logoja dhe vula e degës

Dega e Kolegjit në Tiranë ka logon e saj zyrtare të miratuar nga Kolegji.

Vula e Kolegjit ka formën dhe elementet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi i vendit të origjinës (Belgjikë) dhe prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të atij vendi.

Neni 9

Emërimi i përfaqësuesve

Këshilli i Ministrave dhe Kolegji bien dakord që të gjitha aktivitetet akademike dhe rregullatore për hapjen dhe funksionimin e degës në Shqipëri, do të koordinohen ngushtë ndërmjet Palëve.

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë autorizohet nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje t'i zbatojë ato në emër të Këshillit të Ministrave.

Për Kolegjin, rektori i tij është i autorizuar si koordinator për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Shkëmbimi i informacionit

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët shkëmbejnë informacion të ndërsjellë përkatës ndërmjet tyre.

2. Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përdorë informacionin e marrë, në rastet e ushtrimit të funksioneve të saj ligjore, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

3. Veprimet nga Palët sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, shkëmbimi i informacionit duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Palët do të trajtojnë informacionin e marrë në përputhje me këtë Marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Dispozita përfundimtare

Të dyja palët bien dakord të ruajnë konfidencialitetin të gjitha informacionet jopublike të marra nga Pala tjetër, në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur kërkohet me ligj ose dakordësohet reciprokisht paraprakisht me shkrim.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me përfundimin e procedurave të ratifikimit dhe është në fuqi për një periudhë të pacaktuar, por mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e ndërsjellë të të dyja palëve, të dhënë me shkrim.

Marrëveshja mund të ndërpritet në çdo kohë nga njëra nga Palët, duke informuar palën tjetër me shkrim. Pala që dëshiron të ndërpresë këtë Marrëveshje, duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 24 (njëzet e katër) muaj përpara mbi synimin e saj për të ndërprerë bashkëpunimin dhe këtë Marrëveshje.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, Kolegji dhe Këshilli i Ministrave do të përpiqen ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim, nëpërmjet konsultimit të ndërsjellë.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk ndikon në detyrimet e ndërsjella të Palëve, të cilat vijojnë dhe duhet të përmbushen pavarësisht nga përfundimi i kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë por pa u kufizuar në detyrimet që lidhen me aktivitetet akademike, pagesat ose kompensimet e papaguara, rimbursimin e taksave etj., siç mund të jetë e zbatueshme.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar më _____, në _____, në 4 (katër) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë, 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje, në interpretim teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministër i Arsimit dhe Sportit
Znj. Ogerta Manastirliu

PËR KOLEGJIN E EVROPËS

Rektori
Znj. Federica Mogherini

AGREEMENT
BETWEEN
COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
COLLEGE OF EUROPE
"FOR THE OPENING OF A BRANCH OF THE COLLEGE OF EUROPE IN TIRANA"

This Agreement is entered into between:

The Council of Ministers of the Republic of Albania, represented by Mrs. Ogerta Manastirliu, Minister of Education and Sports, hereinafter referred to as the "Council of Ministers",
and

The College of Europe, a non-profit, public utility organization, registered and licensed in Belgium,¹ represented by the Rector, Mrs. Federica Mogherini, hereinafter referred to as the "College".

In this Agreement, the Council of Ministers and the College are referred jointly to as the "Parties".

WHEREAS:

The College, the oldest postgraduate institute of European studies known for its academic excellence and commitment to contributing to the European integration, aspires to extend its academic activities to the Republic of Albania and the Western Balkans region;

The Republic of Albania is represented in the Administrative Council of the College, with a member appointed by the Ministry of Education and Sport, as defined in the Memorandum of Understanding dated June 7, 2023;

On October 2, 2023, and pursuant to Articles 4 and 10 of the Statutes of the College, the Administrative Council of the College approved the extension of the College to the Republic of

¹ Europacollege / Le Collège d'Europe | Dijver 11 – 8000 Bruges, Belgium | Public utility foundation | Corporate number: 0409.518.855 | VAT number: BE 0409.518.855 | Register of Legal Entities, court of Ghent, Bruges Division.

study department based in Tirana and the conclusion of agreements with the Albanian Government and other cooperation partners for the establishment of the branch of the College in Albania;

On October 6, 2023, a Memorandum of Understanding between the College, the Ministry of Education and Sports of the Republic of Albania and the Municipality of Tirana was signed with the aim to increase the effectiveness and efficiency of the cooperation between these three parties as regards the provision of facilities and the operation of the College of Europe in Tirana;

The Council of Ministers and the College, recognizing the value of higher education for the progress of the integration of the Western Balkans into the European Union (EU), express the joint will to open and maintain a branch of the College in Tirana;

The Parties in this Agreement agree herein on the following:

Article 1 – Common objectives

The Council of Ministers and the College hereby agree that the opening of a branch of the College in Tirana will achieve the following joint objectives of the Parties:

- a) The development of the higher education sector and expertise in the field of European studies in the Republic of Albania and the Western Balkans region;
- b) Providing a unique academic offer to students and professionals from the Western Balkans region, the EU and beyond;
- c) Cultivating an environment of intellectual exchange, international and multicultural understanding and reconciliation, in line with the outstanding academic tradition of the College and its residential formula to study and live Europe together.

Article 2 – Obligations of the Parties

For the purpose provided for in Article 1 of this Agreement, the general division of responsibilities is defined as follows:

- a) The Council of Ministers, hereby approves the opening, establishment, operation and development of the academic activity of a branch of the College in Albania.
- b) The Council of Ministers undertakes to provide support with any available legal means for the establishment, licensing, recognition of foreign accreditation, operation and activity of the branch of the College in Albania. In this regard, the Council of Ministers hereby agrees to address any higher university education regulatory matters regarding the operation of higher education activities (Master's level) in Albania as provided by Law 80/2015 "On the higher education and

the scientific research in the higher education institutions in the Republic of Albania¹”, and any other applicable sublegal acts.

c) The Council of Ministers approves the support with scholarships up to 5 (five) scholarships per academic year for Albanian citizens who will be accepted in the academic programmes of the College with a total value up to 150 000 (one hundred and fifty thousand) euro per academic year;

d) The Council of Ministers provides the facilities and the necessary infrastructure and the building insurance for the normal functioning of the academic activity of the College. The properties and assets, placed at the College's possession for operating its branch in Tirana, are property of the Albanian state. They are provided for use to the College through specific (long-term) loan-for-use contracts, without compensation, and adequately set-up and equipped for the intended academic purposes. The agreements will be signed between the College and the responsible entities that administer the properties.

e) The Council of Ministers ensures through the relevant public authorities the effective implementation of the provisions of the Albanian legislation in force, including but not limited to the Law on Non-Profit Organizations, as amended, Tax Procedures Law, Law on University Education, the Bilateral Agreement between the Commission of the European Community and the Republic of Albania², the double taxation avoidance agreements between the Republic of Albania and the Republic of Belgium³ and any other applicable legal provisions existing or that can be approved in the future, regarding the establishment and operation of the College branch in Albania, any regulatory matter by which it is affected, its other rights and benefits, tax reliefs and exemptions, etc. The Council of Ministers hereby agrees to provide a tax exemption regime for the College and its branch in Albania from any tax or customs duty, of any type or nature. In addition, given that the College and its branch in Albania will have a total tax exemption status, the Council of Ministers undertakes that the suppliers providing goods and services to the College and its branch in Albania will not charge VAT when invoicing to the College and its branch; without contradicting this, the Council of Ministers hereby guarantees that the reimbursement of the VAT, if any, will be made through accelerated procedure.

f) The Council of Ministers undertakes to provide support with any available legal means to the facilitation of the receipt of work permit and residence permit or exemption from the work and/or residence permit, as applicable for the foreign employees of the College and its branch in Albania. In addition, the Council of Ministers hereby guarantees that these foreign employees, if any employees by the College and its branch in Albania, are not obliged to pay the personal tax

¹ Even in case of its amendment or substitution by another substitutive new law.

² Law No. 9840, dated 10.12.2007 “On the ratification of the “Framework Agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the Commission of the European Community on the rules of cooperation on the assistance to Albania, in the framework of the implementation of the Instrument for Pre -accession Assistance (IPA)”.

³ Ratified by Albanian Parliament with Law no. 9051 dated 14.04.2003, effective as of 1.1.2005 (Official Gazette no. 38 dated 23.05.2003, page 1279).

have any obligation to withhold and/or pay such tax and any social and health security contributions for the foreign employees of the College branch in Albania.

g) The College, provided the support by a financial framework from the European Commission, will cover all costs related to personnel, academic, administrative, and operational functioning at the College branch in Tirana, Albania.

Each of the Parties herein will make their best efforts to support the other Party in good faith and effectively keep harmless the other Party from any liability which is not a result of the actions and/or negligence of that other Party.

Article 3 – Academic activity

The study programme(s) to be offered by the College in Tirana will have the same standards as those offered by other departments of the College (in Bruges and Natolin/Warsaw), under the supervision of the Academic Council of the College and accredited by the Accreditation Organization of the Netherlands and Flanders (NVAO).

The rules and procedures for the opening, reorganization, language of study, duration of the study programme(s), as well as for their closure, are defined in the internal regulatory acts of the College.

From the 2024-2025 academic year onwards, the College, through its branch in Tirana, is committed to offering a post-graduate study programme (second cycle of studies, the admission requirements of the College apply) for students and professionals from:

- i) the Western Balkans interested in specializing in European studies, with a focus on the integration of the region in the EU;
- ii) EU member states, as well as any other state, interested in European studies and Southeastern Europe, with a focus on the various transformations in the context of EU enlargement.

Article 4 - Standards of organization and control of the activity of the College branch

Institutional organization standards, academic structure, academic staff standards and their status, procedures for internal and external quality assurance, verification of legality and audit of the activity of the College branch in Albania, is done according to the applicable rules and by the responsible authorities of the country of origin (Belgium).

Article 5 - Admission and registration criteria of students

The rules and procedures provided for in the internal regulatory acts of the College apply to the admission of students to the study programme(s) that will be offered by the College branch in

Article 6 - Graduation and diplomas

The rules provided for in the internal regulatory acts of the College apply to the graduation procedure of students and the form of the diplomas issued by the College.

Diplomas that are issued at the end of the study programme(s) provided by the College are automatically recognized in the Republic of Albania as if issued by any other university institution duly established and operating in the Republic of Albania.

Article 7 - Institutional and study programme accreditation

Institutional accreditation and study programmes provided by the College, as well as their validity period, carried out by the accrediting organizations of the country of origin (Flanders, Belgium), are automatically recognized by the institutions in the Republic of Albania.

Article 8- Logo and seal of the branch

The College branch in Tirana has its own official logo as approved by the College.

The seal of the College has the form and elements as defined by the applicable legislation of the country of origin (Belgium) and is produced, administered and maintained in accordance with the applicable legislation of that country.

Article 9 - Appointment of representatives

The Council of Ministers and the College agree that all academic and regulatory activities for the opening and operation of the branch in Albania will be closely coordinated between the Parties.

The Ministry of Education and Sports of the Republic of Albania is authorized through this Agreement to implement it on behalf of the Council of Ministers.

For the College, its Rector is authorized as coordinator for the implementation of this Agreement.

Article 10 - Exchange of information

1. For the implementation of this Agreement, the Parties exchange mutual relevant information between them.
2. Each of the Parties to this Agreement will use the information received, in cases of exercising its legal functions, only for the purposes defined in this Agreement.
3. Actions by the Parties under this Agreement, and in particular the exchange of information, must be carried out in accordance with the legislation in force for the protection of personal data.
4. The Parties will treat the information received pursuant to this Agreement in accordance with the applicable legislation.

Article 11 – Final provisions

Both Parties agree to keep confidential all non-public information received by the other Party in connection with this Agreement, except as required by law or mutually agreed in advance in writing.

This Agreement shall enter into force upon the completion of the ratification procedures and shall remain in force for an indefinite period, but may be amended only by the mutual written consent of both parties.

The Agreement can be terminated at any time, by one of the Parties, by informing the other party in writing. The party willing to terminate this Agreement must notify the other party in writing at least 24 (twenty-four) months in advance of its intention to terminate the cooperation and this Agreement.

In the event of any dispute arising out of or in connection with this Agreement, the College and the Council of Ministers shall endeavor to resolve the matter amicably through mutual consultation. Termination of this Agreement does not affect the mutual obligations of the Parties, which survive and have to be fulfilled regardless of the termination of this Agreement, including but not limited to obligations related to the academic activities, outstanding payments or compensations, tax reimbursement, etc., as may be applicable.

This Agreement is signed on _____, in _____, in 4 (four) original, equivalent copies, 2 (two) in the Albanian and 2 (two) in the English language. In case of any inconsistency, the English text shall prevail in interpretation.

For the Council of Ministers of the
Republic of Albania:
Minister of Education and Sport
Mrs.Ogerta Manastirliu

For the College of Europe:

Rector
Mrs.Federica Mogherini